



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina

Në bazë të nenit 43, paragrafi 43.1 i Ligjit nr. 03/L -040, për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", nr. 28/15, qershor 2008) dhe të nenit 5 të Udhëzimit administrativ (MAPL) nr. 02/2015, për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit të Kryeqytetit, kryesuesi i Kuvendit të Kryeqytetit

th ë r r e t

seancën e katërt të Kuvendit të Kryeqytetit të Republikës së Kosovës, e cila do të mbahet më 6.5.2025 dhe do të fillojë në orën 10:00.

Seanca do të mbahet në sallën e madhe të Kuvendit të Kryeqytetit, rr. "UÇK", nr. 2.

Për seancë propozon këtë

REND TË DITËS:

1. Miratimi i ekstrakteve të procesverbaleve të seancës së jashtëzakonshme dhe të seancës së tretë të Kuvendit të Kryeqytetit;
2. Propozim-vendimi për hartimin e Planit të hollësishëm rregullues - Çagllavicë;
3. Raporti financiar buxhetor i Komunës së Prishtinës për periudhën 1 janar - 31 mars 2025 (TM1);
4. Propozim-vendimi lidhur me Planin lokal të veprimit për barazi gjinore 2025-2026;
5. Propozim-vendimi për formimin e grupit punues për hartimin e Planit vjetor të punës së Kuvendit për vitin 2025;
6. Propozim-vendimi për vënien në diskutim publik të Strategjisë së Prishtinës për artin dhe kulturën 2026-2031;
7. Propozim-vendimi për miratimin e Rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës;
8. Propozim-vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës NPL-së "Trafiku Urban", SHA;
9. Propozim-vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Ministrisë së Punëve të Brendshme –Policisë së Kosovës;

Faqe 1 nga 2

10. Propozim-vendimi për dhënie në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, Këshillit Prokurorial të Kosovës;
11. Propozim-vendimi për caktimin e komisioneve për rekrutim të drejtorëve dhe zëvendës drejtorëve të institucioneve edukativo-arsimore dhe aftësuese në Kryeqytetin e Republikës së Kosovës, në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
12. Pyetje dhe përgjigje;
13. Të ndryshme.

KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-060/01-54117/25, më 17.4.2025

KRYESUESI I KUVENDIT

Fehmi Kupina

